



Breaking News:

Policia e Shtetit/Vijon operacioni i koduar “The Wanted”, ekstradohet nga Greqia, 1 shtetas

|| << >>



11/06/2025

Shkodër/Dyshohet Se Posedonte 2 Armë Zjarri Kallashnikov, Kapet Dhe Vihet Në Pranga 19-Vjeçari

Shkodër/Vijojnë kontrollet mbi bazën e inteligjencës policore, për kapjen e shtetasve të shpallur në kërkim.

Dyshohet se posedonte 2 armë zjarri kallashnikov, kapet dhe vihet në pranga 19-vjeçari.

Si rezultat i kontrolleve të vazhdueshme për lokalizimin dhe kapjen e shtetasve në kërkim, bazuar dhe në informacionet e siguruara nga inteligjencia policore, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Shkodër kanë lokalizuar, kapur dhe ndaluar shtetasin:

A. Gj., 19 vjeç, banues në fshatin Kir.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim, pasi më datë 30.05.2025, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, shërbimet e Policisë kanë ushtruar kontroll në një automjet, në një lagje të fshatit Kir, ku kanë gjetur dhe sekuestruar 2 armë zjarri kallashnikov të cilat dyshohet se i posedonte shtetasi A. Gj.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

◀ Drejtori i Përgjithshëm Ilir Proda pret në takim përfaqësues të misionit PAMECA dhe të programit EU4LEA,

Shëngjin/Finalizohet operacioni policor i koduar “Kamuflimi” ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)